



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

DREJTORIA E FINANCE BUXHET DHE KONTABILITET

Nr. 913 prot

Fier, më 23.01.2026

PROJEKT VENDIM

Nr. 08 datë 23.01 2026.

“Për miratimin e ndryshimit (shtesë fondesh të trashëguara nga Granti i Performancës me burim financimi buxheti i shtetit, si dhe shtesë në buxhet për Grantin e Performancës bazuar në financim të huaj) në VKB nr. 118, datë 11.12.2025, ‘Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026–2028 dhe të buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2026’.”

Mbështetur në:

Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenet 34, 40, 41, 54 dhe 55;

Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu III, nenet 10–20, Kreu IV, nenet 20–29, Kreu VII, nenet 39–40;

Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;

Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 118, datë 11.12.2025, “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026–2028 dhe buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2026”;

Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;

Aneksin nr. 9 të Ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, i ndryshuar;

Udhëzimin e përbashkët nr. 1, datë 11.07.2025, të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Shtetit për Pushtetin Vendor, “Për kriteret, procedurat dhe treguesit për shpërndarjen e fondit të grantit të bazuar në performancë për bashkitë për vitin 2025”;

Shkresën e Ministrisë së Financave nr. 18133/1 prot., datë 24.12.2025, protokolluar pranë Bashkisë Fier me nr. 11993 prot., datë 27.12.2025, “Detajim i fondit të Grantit të Bazuar në Performancë për bashkitë për vitin 2025, me burim financimi nga Buxheti i Shtetit” si dhe dërgimin e shkresës përcjellëse mbi vendimin përfundimtar të Komitetit të Vlerësimit të Performancës (KVP) në kuadër të GBP 2025”;

Ekzekutivi i Bashkisë Fier,

PROPOZON:

- I. Të shtohet buxheti i Bashkisë Fier nga Granti i Bazuar në Performancë, me burim financimi nga Buxheti i Shtetit, si e ardhur e trashëguar e akorduar për vitin 2025, në vlerën 1.258.426,97 (një milion e dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë e katërqind e njëzet e gjashtë presje nëntëdhjetë e shtatë) lekë.

Entiteti I qeverisjes	Ministria e Linjes	Kod institucioni	Emertimi I Institucionit	Kap	Prog.	Llog. Ekon.	Kod Thesarit	Emertimi I produktit	Shuma
111	00	2111001	Bashkia Fier	01	04960	6040000	0909	Grand performance me burim financimi Buxheti i Shtetit	1,258, 426.97
Shuma									1,258, 426.97

II. Të shtohet Buxheti i Bashkisë Fier nga Granti i Bazuar ne Performance me burim financimi i huaj me vlerën **1,555,530.46**(një milion e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tridhjetë pike dyzetë e gjashtë) **lekë**

- **Buxheti i Bashkisë shkon nga 3,021,214,095** (tre miliard e njëzet e një milion e dyqind e katërmbëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e pesë) **lekë** do të shkoj në **3,024,028,052.43** (tre miliardë e njëzet e katër milionë e njëzet e tetë mijë e pesëdhjetë e dy presje dyzet e tre) **lekë**

III. Granti i Bazuar në Performancë, si ai me burim financimi nga Buxheti i Shtetit, ashtu edhe ai me burim financimi të huaj, të përdoret për “Blerje, instalim dhe integrim i një sistemi softuerik për menaxhimin financiar dhe kontabilitetin publik” për aparatit e Bashkisë Fier dhe ndërmarrjet në varësi.

Entiteti I qeverisjes	Ministria e Linjes	Kod institucioni	Emertimi I Institucionit	Kap	Prog.	Llog. Ekon.	Kod Thesarit	Emertimi I produktit	Shuma
111	00	2111001	Bashkia Fier	01	AA111	2303000	0909	Blerje, instalim dhe integrim i një sistemi softuerik për menaxhimin financiar dhe kontabilitetin publik	1,258, 426.97
111	00	2111001	Bashkia Fier	02	AA111	2303000	0909	Blerje, instalim dhe integrim i një sistemi softuerik për menaxhimin financiar dhe kontabilitetin publik	1,555,530.46
Shuma									2,813,957.43

IV. Për zbatimin e këtij projekt vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit, të Bashkisë Fier.

Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit
Pranvera Çina

Drejtoria Juridike
Esmeralda Kapllanaj

KRYETARI
Armando Subashi

